



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2018:048037

Datë: 10.07.2024

Numri i dokumentit: 05919025

P.nr.340/2018

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC / Divizioni Penal, gjyqtari Mizahir Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Afrim Gashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit F.K nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale të vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.nr.1199/2018 të datës 27.08.2018, me datë 02.07.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.1199/2018 të datës 27.08.2018, dhe kundër të akuzuarit F.K nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale të vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, **PUSHOHET** procedura penale, për shkak të **parashkrimit absolut të ndjekjes penale**.

E dëmtuara K-divizioni në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

Shpenzimet e procedurës penale bijnë në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzë PP.nr.1199/2018 të datës 27.08.2018, kundër të akuzuarit F.K nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Pas shikimit të shkresave të lëndës, gjyqtari ka konstatuar se aktakuza PP.nr.1199/2018 të datës 27.08.2018, gjykatës i është dorëzuar me datë 30.08.2018, e që rezulton nga vula për pranimin e shkresave në gjykatë.

Me verifikimin e aktakuzës si dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se Prokuroria Themelore në Gjakovë , e ka akuzuar të akuzuarin F.K nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale të vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, të kryer me datën 19.06.2018.

Për veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vite.

Me verifikimin e shkresave të lëndës, është konstatuar se për veprën penale të vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, ka arritur parashkrimi në kuptim të nenit 99 paragraf.1 nën par 1.5 të KPRK-se, sipas të cilit ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar gjashtë (6) vjet, nga koha e kryerjes së veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vjet burgim.

Kurse bazuar në nenin 100 par.8 të KPRK-se, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (parashkrimi absolut i ndjekjes penale).

Ndërsa në rastin konkret kanë kaluar më shumë se gjashtë (6) vite, nga koha e kryerjes së veprës penale, e paraparë me këtë dispozitë ligjore, pasi që sipas aktakuzës, rezulton që vepra penale të jetë kryer me datë 19.06.2018, andaj nga ky fakt rezulton të ketë lindur parashkrimi absolut për këtë vepër penale.

Vendimin mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko – civil, për realizimin e kërkesës pronësore – juridike, gjykata e bazoi në nenin 462 par.3 të KPPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e bazoi në nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 357 par.1 pika.1.3 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
- Divizioni Penal –
P.nr.340/2018 me datën 02.07.2024.

B. Profesional
Afrim Gashi

Gj y q t a r i
Mizahir Shabani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa, në afat prej tri (3) ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes të kësaj gjykate.